



Pranuar / Dorezuar Priljenol/Protato Received / Delivety	19.09	2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Judicial Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shënje Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKMST/CK	3545	/2023	1/3	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.441/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani -anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, në lidhje me ankesën A.nr.441/2023 të datës 01.03.2023 e ankuesit të bashkuar me ankesat tjera sipas vendimit të kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës VK/2023 të datës 05.04.2023 kundër organit të punësimit Administrata Tatimore e Kosovës/Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “Transferim”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.9 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën e mbajtur me datë 14.04.2023, mori këtë:

V E N D I M

Pezullohet procedura lidhur me ankesën A.nr.441/2023 të datës 01.03.2023 e ankuesit të bashkuar me ankesat tjera sipas vendimit të Kryetarit të Këshillit Nr.VK/2023 të datës 05.04.2023.

A r s y e t i m

Ankuesit, kanë parashtruar ankesa në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në çështjen juridike “Transferim”, kundër organit të punësimit Administrata Tatimore e Kosovës/Ministria e Punëve të Brendshme-DMZP dhe at ankuesi sipas ankesës A.nr.441/2023 të datës 01.03.2023 të bashkuar me ankesat A.nr.391/2023 të ankuesit i, ankesës A.nr.396/2023 të ankuesit ankesës A.nr.397/2023 të ankuesit dhe ankesës A.nr.409/2023 të ankuesit

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, duke marr parasysh faktin se gjatë kohës së shqyrtimit të këtyre ankesave përkatësisht afatit ligjor të vendimmarrjes, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës konform Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nenit 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3, nenit 20 paragrafi 2, si dhe nenit 4 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe nenit 6 të rregullores Nr.04/2018 për Procedurën e Monitorimit të Institucioneve të Administratës Publik ka marrë Vendimin VMK/2023 me Nr.Protokolli 1851/2023 datë 16/02/2023 për monitorim të

jashtëzakonshëm në Administratën Tatimore të Kosovës dhe Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme në lidhje me vlerësimin e ligjshmërisë së procesit të transferimit të nëpunësve civil si pasojë e riorganizimit të brendshëm të Administratës Tatimore të Kosovës, dhe si rrjedhojë rezultoi se është objekti i shqyrtimit që është duke u trajtuar është i njëjti me këto ankesa që janë objekt i këtij vendimi përkatësisht ankesat që janë bashkuar, andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në mbështetje të nenit 85 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: *“Kur organi publik që zhvillon procedurën has në një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e çështjes kryesore dhe e cila përbën një çështje juridike të pavarur (në vijim: “çështje paraprake”), për zgjidhjen e së cilës është kompetente një gjykatë apo organ tjetër, organi publik që zhvillon procedurën do të pezullojë çështjen kryesore, deri sa çështja paraprake të jetë vendosur dhe do të njoftojë palën për vendimin e pezullimit”,* dhe ndërlidhur me Ligjin Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përkatësisht nenin 20 paragrafi 3,4 dhe 5 i cili parasheh: *“3.Anëtari i Këshillit është i obliguar që të paraqet raportin me të gjetura dhe rekomandime në mbledhjen e Këshillit dhe të jep sqarime për të gjitha çështjet e ngritura nga Këshilli,4.Këshilli, pas shqyrtimit të raportit nxjerr vendim, të cilin së bashku me raportin ia dërgon institucionit përkatës,5.Institucioni përkatës i administratës publike është i obliguar për zbatimin e rekomandimeve të Këshillit, brenda afatit të përcaktuar me vendimin e Këshillit”,* konstaton se mbi bazën ligjore të potencuar si më lartë dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.9 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi për: **Pezullim të procedurës në lidhje me ankesën A.nr.441/2023 të datës 01.03.2023 të ankuesit Burim Mehulli të bashkuar me ankesat tjera sipas vendimit të kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me shifër VK/2023 të datës 05.04.2023.**

Procedura në lidhje me vendimmarrjen lidhur me ankesën A.nr.441/2023 të datës 01.03.2023 të ankuesit _____ është bashkuar me ankesat tjera sipas vendimit të kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me shifër VK/2023 të datës 05.04.2023, do të mbetet e pezulluar deri në vendosjen përfundimtare të kësaj çështje nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në vendimin VMK/2023 me Nr.Protokolli 1851/2023 datë 16/02/2023 për monitorim të jashtëzakonshëm në Administratën Tatimore të Kosovës dhe Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Nga ajo që u tha më lartë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.9 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.441/2023, datë 14/04/2023

Elakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesve;
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-

